



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KUVENDI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 11, 12.2 shkronja d) dhe 82 paragrafët 2 dhe 3 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, në pajtim me Rregulloren (QRK) nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, nenit 53 të Ligjit për procedurën e përgjithshme administrative nr.05/L-031, neneve 14, 15 paragrafi 2.4, dhe nenin 90 paragrafët 2 dhe 3 të Statutit të Komunës, nr.01-020/01-0050862/18, *Shkresës nr.43-1020 datë 25.11.2022 të Ministrisë së Pushtetit Lokal, përmes të cilës janë përcjellë Raportet e vlerësimeve të ligjshmërisë të Ministrive të linjës për aktin e Komunës së Podujevës*, Kuvendi i Komunës së Podujevës, pas rishqyrtimit të aktit në mbledhjen e mbajtur më 09 dhjetor 2022, mori këtë,

V E N D I M

Neni 1

1. Me këtë vendim anulohet Rregullorja nr.prot.01-431/03-0093814/22 për taksa tarifa dhe gjoja komunale, e miratuar nga Kuvendi i Komunës në mbledhjen e datës 03 nëntor 2022.
2. Ekzekutivi i Komunës, përkatësisht Drejtoritë dhe sektorët përkatëse të fillojnë me përgatitjet e draftit të ri sipas vlerësimeve dhe rekomandimeve të Ministrive si dhe konsultimeve paraprake.

Neni 2

Arsyeja e anulimit sipas nenit 1 është për shkak se disa prej Ministrave të linjës kanë vlerësuar se akti në fjalë nuk është në përputhje me dispozitat ligjore dhe nënligjore në fuqi dhe duke kërkuar harmonizimin e të njëjtës sipas rekomandimeve përkatëse, mirëpo meqë nga Komuna është vlerësuar se për harmonizimin e aktit kërkohet punë, angazhim dhe koordinim me Ministrinë e linjës, e që kjo nuk mund të bëhet brenda një kohe të shkurtër, e njëjta anulohet dhe njëkohësisht kërkohet ri draftimin sipas rekomandimeve të Ministrive përkatëse.

Neni 3

Vendimi hynë në fuqi 7 ditë pas publikimit në ueb faqe zyrtare të Komunës së Podujevës.

Nr.Prot. 01-431/03-0101083/22
Podujevë, datë; 09 dhjetor 2022

